

Matura Shtetërore 2017
UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1

Formulari A1

1. **Formulari A1** plotësohet online. Procedura e plotësimit inline do të bëhet sipas një udhëzimi të veçantë.
2. **Formularin A1** e plotësojnë vetëm maturantët e vitit shkollor 2016 – 2017.
3. Plotësimi i **Formularit A1** fillon në Portalin Qeveritar, dhe përfundon në shkollë.
4. Procesi i plotësimit të **Formularit A1** në shkollë ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që quhet “mbikëqyrës”.
5. Mbikëqyrësi pajiset me kodin përkatës të hyrjes në sistem. Vetëm pasi mbikëqyrësi fut kodin në sistem, maturanti mund të përfundojë plotësimin e **Formularit A1** në shkollë.
6. Lista me të dhënat e marra nga plotësimi i formularëve printohet, nënshkruhet nga maturanti e mbikëqyrësi dhe vulozet nga drejtori i shkollës ku plotësohen formularët A1. Listat ruhen deri në përfundim të Maturës Shtetërore 2017.

I. TË DHËNA PERSONALE

Plotësohen nga maturanti.

- **Tek pika 1**, (numri personal i letërnjoftimit ID), maturanti shënon numrin e tij personal që ka në dokumentin e identifikimit.
Për të dhënat **2-5**, pasi maturanti bën plotësimin, sistemi bën verifikimin e tyre dhe nuk lejon të vazhdohet aplikimi, nëse ka pasaktësi.
- **Tek pika 6**, maturanti shënon në fushat përkatëse, numrin e telefonit dhe adresën e email-it, të cilat duhet të ruhen të pandryshuara deri në fund të Maturës Shtetërore 2017, me qëllim që maturanti të marrë informacion në faza të ndryshme të procesit. Nëse maturanti nuk ka telefon, ose nuk dëshiron të shënojë numrin e telefonit, atëherë mbikëqyrësi shënon numrin e tij të telefonit.
- **Tek pika 7**, shënohet X tek kutizat pranë Po ose Jo.

II. TË DHËNA SHKOLLORE

Të dhënat shkollore do të plotësohen në bashkëpunim me **mbikëqyrësin** e sallës ku bëhet aplikimi. Për plotësimin saktë të kërkesave të këtij grupimi, maturanti dhe mbikëqyrësi duhet të marrin informacion të saktë dhe të plotë për secilën nga rubrikat përkatëse:

Plotësohen nga maturanti.

- **Tek pika 8**; (emri i qytetit/fshatit), maturanti shënon emrin e qytetit/fshatit ku ndodhet shkolla ku po ndjek studimet.
- **Tek pika 9**; (emri i shkollës ku studjon), maturanti shënon emrin e shkollës ku po studion.

Plotësohen nga mbikqyrësi.

- **Tek pika 10**, mbikqyrësi plotëson emrin e DAR/Za-së përkatëse.
- **Tek pika 11**, (indeksi i profilit), mbikqyrësi zgjedh nga lista numrin dyshifror që i përket shkollës ku ndjek studimet maturanti, sipas listës së miratuar nga MAS.
- **Tek pika 12**, (emërtimi i profilit) mbikqyrësi plotëson emrin e profilit/degës.
- **Tek pika 13**, mbikqyrësi plotëson klasën dhe paralelin e klasës ku po studjon maturanti.
- **Tek pika 14**, zgjidhet nga lista, gjuha e huaj që në planin mësimor të shkollës trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar, në nivelin gjuhësor B1.

III. TË DHËNA LËNDORE

Plotësohen nga maturanti.

- **Tek pika 15**, maturanti zgjedh nga lista lëndët Z1 dhe Z2 që dëshiron të japë provim.
- Zgjedhja e lëndëve Z1 dhe Z2 bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 26, datë 29.12.2016, të MAS dhe MMSR.
- Numri i lëndëve që do të zgjidhen duhet të jetë detyrimisht 2 (dy).
- Shuma e krediteve të dy lëndëve që zgjidhen, duhet të jetë jo më e vogël se 8 (tetë).
- Kur zgjidhet një lëndë bërthamë, nuk mund të zgjidhet e njëjta lëndë e thelluar (përfshirë lëndët e detyruara).
- Maturanti ka të drejtë të zgjedhë si lëndë me zgjedhje, gjuhën e huaj të cilën parapëlqen nëse e ka zhvilluar ose jo në shkollë, në nivelin gjuhësor B2.
- Maturantët e shkollave artistike mund të zgjedhin vetëm një të njënjtë nga lëndët e grupit II: “Për shkollat artistike”. Lëndën tjetër duhet ta zgjedhin nga grupi i lëndëve të grupit I “Për shkollat e mesme (Gjimnazet)”.
- Teoria profesionale është e zberthyer në profile sipas indeksit të shkollave.
- Maturantët e shkollave profesionale duhet të zgjedhin detyrimisht një të njënjtë nga lëndët me zgjedhje në grupin II “Teoria profesionale e integruar me zgjedhje të detyruar” dhe lëndën tjetër e zgjedh nga grupi i I “Për shkollat e mesme (Gjimnazet)”.